

# NEWSLETTER E DIASPORËS

PERFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

#107

## SHQIPËRI-UKRAINË/ Nisma të përbashkëta për komunitetin shqiptar



Shqipëria dhe Ukraina përforcojnë marrëdhëniet mes tyre me një sërë nismash të cilat përfshijnë dhe komunitetin shqiptar atje.

Në takimin e ministrit të Diasporës Pandeli Majko dhe Konsullin e Nderit të Republikës së Shqipërisë në Ukrainë, Shahin Omarov u diskutua për një sërë nismash.

Në këtë bashkëbisedim u bisedua për hapjen e një qendre të kulturës shqiptare në Universitetin e Izmailit këtë vit. Gjithashtu u fol për përgatitjen dhe nënshkrimin e një memorandumi binjakëzimi mes bashkisë së Korçës dhe komunës së Karakurtit në Ukrainë. Këtë vit do të ketë dhe një pullë postare të përbashkët Shqipëri-Ukrainë si dhe do të organizohen aktivitete të përbashkëta me Agjencinë Kombëtare të Diasporës.



## "Apliko online për rinovimim e dokumenteve biometrike"

Të interesuarit për të drejtën e votës në migracion mund të marrin më shumë informacion në faqen e Web-it të Komisionit të Reformës Zgjedhore.

## MËSUESIT NË DIASPORË/ Shtyhen aplikimet deri në fund të shtatorit për regjistrin

Qendra e Botimeve për Diasporën ka njoftuar se afati i aplikimeve të mësuesve të gjuhës shqipe për tu bërë pjesë e regjistrit të mësuesve në Diasporë është shtyrë deri në fund të muajit shtator. Sipas urdhrin të lëshuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar gjatë muajit maj të çdo viti kalendarik duhet të shpallë kërkesën për aplikime. Afati i përfundimit të aplikimit do të jetë data 30 shtator i çdo viti.

Sipas ndryshimeve të paraqitura në urdhrin e ri mësuesit e interesuar për tu bërë pjesë e regjistrit duhet të paraqesin në dokumentacion edhe kopje të certifikatave dhe kualifikimeve si mësues të gjuhës shqipe, të marra në Shqipëri ose vende të tjera (nëse i disponojnë) si dhe një dokument që vërteton se kandidati jep mësimin e gjuhës shqipe i përkthyer dhe i noterizuar (ku të saktësohet nëse është institucion publik ose privat, nëse është punë me kohë të plotë ose të pjesshme) më përjashtim të rasteve kur ky dokument lëshohet nga përfaqësitë diplomatike.



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

## DIGI DIASPORA/ Takimi i parë, teknologjia në funksion të sipërmarrjes



Këtë javë u mbajt takimi i parë i "Digi Diaspora", ku të ftuarit ndanë eksperiencat dhe njohuritë e tyre në fushën e teknologjisë, përmes angazhimit të diasporës shqiptare, me synim forcimin e kapaciteteve të bizneseve lokale dhe komunitetit digjital, si dhe rrjetëzimit profesional.

Organizimi i tipit uebinar, ku përveç prezantimeve nga të ftuarit, ju dha mundësia të gjithë pjesëmarrësve të bënin pyetje rreth temës së teknologjisë. Në këtë event, u fol edhe për profesionistët shqiptarë në fushën e IT-së, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre jashtë Shqipërisë.

Organizimi i tipit uebinar, ku përveç prezantimeve nga të ftuarit, ju dha mundësia të gjithë pjesëmarrësve të bënin pyetje rreth temës së teknologjisë. Në këtë event, u fol edhe për profesionistët shqiptarë në fushën e IT-së, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre jashtë Shqipërisë.




Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes si agjentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online

## Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"



App store: [këtu](#) Play store: [këtu](#)

## Digjitalizimi i Veprave Shqiptare



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen